

*Jasmin Krasniqi
Konferencës së
Kryetarve*



KUVENDI
NR 2947 DATE 02.10.23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË SOCIALISTE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____

Drejtuar: Znj. Lindita NIKOLLA
KRYETARE E KUVENDIT

Lënda: Kërkesë përmision dhe miratim Projekt-Rezolute "Për dënimin e sulmit të armatosur terrorist në veri të Republikës së Kosovës dhe mbështetjen e përpjekjeve përgarantimin e sigurisë dhe paqes në vend e në rajon".

Enderuar znj. Kryetare,

Bazuar në nenet 98 dhe 99 të Rregullores së Kuvendit, paraqes për shqyrtim dhe miratim në Kuvend projekt-rezolutën "Për dënimin e sulmit të armatosur terrorist në veri të Republikës së Kosovës dhe mbështetjen e përpjekjeve përgarantimin e sigurisë dhe paqes në vend e në rajon".

Ju faleminderit.

KRYETARI I GRUPIT PARLAMENTAR TË PARTISË SOCIALISTE

Bledar ÇUÇI



REPUBLIKA E SHQIPĒRISË
KUVENDI

REZOLUTË

**PËR DËNIMIN E SULMIT TË ARMATOSUR TERRORIST
NË VERI TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE MBËSHTETJEN E PËRPJEKJEVE PËR GARANTIMIN
E SIGURISË DHE PAQES NË VEND E NË RAJON**

- Thellësish të shqetësuar për situatën e krijuar në Republikën e Kosovës pas sulmit të organizuar ushtarak dhe kriminal të një njësie terroristësh serbë në veri të vendit, më datë 24 shtator 2023;
- Në mbështetje të plotë të sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës si dhe institucioneve të saj Kushtetuese;
- Në mbrojtje të vlerave demokratike, sigurisë dhe paqes në Kosovë dhe në rajon;
- Në përputhje me angazhimet Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë dhe politikën e mbrojtjes së interesave strategjike kombëtare midis Shqipërisë dhe Kosovës;

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

- Dënon ashpër sulmin e armatosur dhe të organizuar terrorist mbi Policinë e Kosovës më datë 24 shtator 2023, i cili i mori jetën një punonjësi të Forcave të Policisë së Kosovës dhe shkaktoi dy të plagosur nga radhët e saj.
- Përgëzon institucionet e sigurisë së Republikës së Kosovës për maturinë dhe profesionalizmin e tyre si dhe vlerëson forcat e EULEX-it dhe KFOR-it përgatishmërinë, bashkëpunimin dhe angazhimin, në aksionin përzmbajtjen e sulmeve kriminale të njësive terroriste dhe neutralizimin e përpjekjeve përpshkallëzimin e konfliktit në veriun e Kosovës dhe destabilizimin e vendit.
- Mbështet çdo masë dhe veprim të ndërmarrë nga Qeveria dhe institucionet e Kosovës për të parandaluar e goditur me mjete kushtetuese e ligjore përpjekjet për të cënuar, rrrezikuar, sulmuar dhe rrëzuar rendin kushtetues të Republikës së Kosovës, jetën, sigurinë dhe harmoninë e qytetarëve të saj.
- Kërkon nga Serbia që të heqë dorë nga qëndrimet dhe veprimet armiqësore e luftënxitëse ndaj Republikës së Kosovës, të hapë një hetim serioz e transparent ndaj tërë organizatorëve dhe shkaktarëve të operacioneve ushtarake terroriste ndaj Republikës së Kosovës dhe të dorëzojë kriminelët.
- Kërkon nga faktori ndërkombëtar që të ushtrojë ndikimin e tij për ta ballafaquar Serbinë me rolin e saj në raport me organizimin dhe mbështetjen politike, logistike e morale të akteve të grupit terrorist në veri të Republikës së Kosovës.
- Inkurajon dhe përkrah të gjitha institucionet e Kosovës për punën, përkushtimin dhe përpjekjet që synojnë integrimin e plotë dhe bashkëjetesën e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës.
- I bën thirrje Bashkimit European, Shteteve të Bashkuara dhe aleatëve tanë strategjik që të ngrenë në nivelin me të lartë alarmin dhe aksionin demokratik për të parandaluar rrzikun eminent që po i kanoset sigurisë dhe paqes në Kosovë, në rajon e më gjërë.

- Vlerëson se prania e shtuar e KFOR-it në veri të Kosovës është një garanci për paprekshmërinë e kufijve të saj si dhe për sigurinë dhe paqen në tërë rajonin.
- Mbështet përpjekjet e autoriteteve të Kosovës për normalizimin dhe ndërtimin e marrëdhënieve të fqinjësisë në një frysme paqësore e bashkëpunimi dhe bashkohet me qëndrimet e Presidentes së Republikës së Kosovës për vijimin e dialogut Kosovë-Serbi mbi bazën e një projekti të përpiluar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës lidhur me asociacionin, i cili duhet të jetë brenda kornizës kushtetuesc të Republikës së Kosovës dhe në përputhje me kërkesat legjitime të saj.

KRYETARE

Lindita NIKOLLA

Miratohet, në datë _____